

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 2 shkurt 2012

Origjinali: anglisht

**NË DHOMËN GJYQËSORE II**

**Para:** Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës  
Gjykatësit Burton Hall  
Gjykatësit Guy Delvoie

**Sekretar:** Z. John Hocking

**Vendim:** 2 shkurt 2012

**PROKURORI**

**k.**

**RAMUSH HARADINAJT  
IDRIZ BALAJT  
LAHI BRAHIMAJT**

*PUBLIK*

**VENDIM MBI MOCIONIN E PROKURORISË PËR ZËVENDËSIMIN E  
PROVËS MATERIALE NË DOKUMENTACIONIN GJYQËSOR ELEKTRONIK**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Paul Rogers

**Avokatëve të të Akuzuarve**

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn  
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen M. Rohan për Idriz Balajn  
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

**KJO DHOMË GJYQËSORE** (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”);

**DUKE MARRË SHËNIM** “Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e transkripteve të dëshmive në vend të dëshmive gojore sipas Rregullës 92bis” lëshuar publikisht më 22 korrik 2011, në të cilin Dhoma pranoi deklaratën me shkrim të Branimir Aleksandriqit<sup>1</sup> (“Deklarata”) bazuar në Rregullën 92bis të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”);

**PASI KA MARRË** “Mocion i Prokurorisë për leje për zëvendësimin e provës materiale në dokumentacionin elektronik gjyqësor” paraqitur publikisht më 6 janar 2012 (“Mocioni”), në të cilin Prokuroria njofton Dhomën se për shkak të pakujdesisë, versioni i Deklaratës i vendosur në dokumentacionin elektronik gjyqësor nuk është i njëjtë me versionin e Deklaratës së pranuar si provë në çështjen *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, për shkak se në të nuk janë përfshirë redaktimet e pranuar nga Palët në atë gjykim, dhe për këtë arsye kërkon leje për zëvendësimin e saj në dokumentacionin gjyqësor elektronik;<sup>2</sup>

**DUKE MARRË SHËNIM** se asnjë prej të Akuzuarve nuk paraqiti përgjigje ndaj Mocionit;

**DUKE MARRË PARASYSH** se versioni ekzistues i Deklaratës në dokumentacionin gjyqësor elektronik të gjykatës nuk përputhet me versionin e paraqitur si provë sipas Rregullës 92bis;

**PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA dhe NË PËRPUTHJE ME** Rregullën 54 të Rregullores, Dhoma:

<sup>1</sup> Dokumenti numër 01260 i Rregullës 65ter.

<sup>2</sup> Dokumentet me numrat identifikues U016-8487-red dhe U016-8432-red.

**LEJON** Prokurorinë të zëvendësojë versionin ekzistues të Deklaratës në dokumentacionin elektronik të gjykatës me dokumentin që u pranua si provë në çështjen *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/  
Gjykatës Bakone Justice Moloto  
Kryegjykatës

Sot, më datën 2 shkurt 2012.  
Në Hagë  
Holandë

**[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]**